REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2689/3 Prot.

Vlorë më, 06 . 10 .2026

VENDIM

Nr. 58, datë 06 . 10 .2026

PËR
RIALOKIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2026–2027, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 38 dhe të nenit 69, pika 3, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Urdhrit të Përbashkët nr. 108, datë 15.06.2026, "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2026–2027"; të nenit 19, pika 1, shkronja "f", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 61, pikat 3 dhe 4, të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe referuar relacionit të Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave, përcjellë me shkresën nr. 2690/1 prot., datë 06.10.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 06.10.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë rialokimin e kuotave të pranimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2026–2027, sipas propozimeve të Fakultetit të Shëndetit dhe Fakultetit të Ekonomisë, si më poshtë:

I. FAKULTETI I SHËNDETIT

a) Të rialokohet 1 (një) kuotë nga kategoria "Kandidatët nga Kosova" në programin Master i Shkencave në Shkenca Infermierore, në kategorinë "Shqiptarë brenda vendit".

b) Të rialokohen 2 (dy) kuota nga kategoria "Kandidatët nga Kosova" në programin Master i Shkencave në Shkenca Infermierore, në kategorinë "Transferimet".

c) Të rialokohen 5 (pesë) kuota nga kategoria "Kandidatët e huaj" në programin Master Profesional në Infermieri Pediatrike, në kategorinë "Shqiptarë brenda vendit".

d) Të rialokohet 1 (një) kuotë nga kategoria "Kandidatët nga Kosova" në programin Master Profesional në Infermieri Pediatrike, në kategorinë "Shqiptarë brenda vendit".

e) Të rialokohet 1 (një) kuotë nga kategoria "Kandidatët romë dhe ballkano-egjiptianë" në programin Master Profesional në Infermieri Pediatrike, në kategorinë "Shqiptarë brenda vendit".

II. FAKULTETI I EKONOMISË

a) Të rialokohen 8 (tetë) kuota nga kategoria "Shqiptarë brenda vendit" në programin Master i Shkencave në Administrim Publik, në kategorinë "Studentë që aplikojnë për program të dytë studimi".

b) Të rialokohen 10 (dhjetë) kuota në programin Master i Shkencave në Financë, nga të cilat 6 (gjashtë) kuota nga kategoria "Kandidatët nga trojet" dhe 4 (katër) kuota nga kategoria "Transferime", në kategorinë "Shqiptarë brenda vendit".

2. Rialokimet e miratuara me këtë vendim nuk ndryshojnë numrin e përgjithshëm të kuotave të miratuara për programet e ciklit të dytë të studimeve, sipas Vendimit të Senatit Akademik nr. 22, datë 30.04.2026, "Për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në të gjitha ciklet e studimit për vitin akademik 2026–2027".

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Fakulteti i Shëndetit, Fakulteti i Ekonomisë dhe strukturat përgjegjëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

4. Bashkëlidhur këtij vendimi është tabela e kuotave për programet e studimit të sipërcituara.

5. Ky vendim përcillet për miratim në Ministrinë e Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Aurela Saliaj

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Nr.	*Njësia Kryesore*	*Programi I Studimit*	*Cikli I Studimit*	*TOTAL KUOTA 2026-2027*	*Shqiptarë Brenda vendit*	*Që aplikojnë për Program II*	*Që aplikojnë për Transferim studimesh*	*Shtetas me diplomë të huaj*	*Me statusin e jetimit*	*Persona me aftësi të kufizuar*	*Romë + ballkano egjiptiane*	*Kosovë*	*Maqedoni*	*Mal i Zi*	*Preshevë*	*Bujanovë*	*Medvegje*	*Total troje*
1	**FE**	Administrim Publik	MS	70	52	10	3	1	1	1	1	0	0	1	0	0	0	1
2	**FE**	Finance	MS	41	30	6	1	1	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0
3	**FSH**	Shkenca Infermierore	MS	25	21	2	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4	**FSH**	Infermieri Pediatrike	MP	30	27	1	0	0	1		0	1	0	0	0	0	0	1